

TË RINJ TË SIGURT NGA PROPAGANDA EKSTREMISTE ONLINE

Këshilla për fëmijët dhe prindërit





U.S. EMBASSY
Tirana, Albania

Botimi është pjesë e projektit “Rritja e rezistencës ndaj ekstremizmit të dhunshëm në ekosistemin kibernetik shqiptar”, i mbështetur financiarisht nga Zyra për Marrëdhënie me Publikun e Ambasadës së SHBA në Tiranë.

Opinionet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura janë të autorit /eve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Departamentit të Shtetit.

Botues: Akademia e Studimeve Politike

Adresa: Qendra Kotoni, Rr.Donika Kastrioti, Nr.3, Kati 4, Zyra 2, Tiranë

Tel: +355 04 2272173, email; info@asp.al, web: www.asp.al

© ASP 2020 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për Akademia e Studimeve Politike, Tiranë/Shqipëri

PËRMBAJTJA

1. MODULI I - TË NJOHIM EKSTREMIZMIN E DHUNSHËM	4
1.1 PËRKUFIZIME	4
1.2 EKSTREMIZMI I DHUNSHËM DHE RADIKALIZIMI	4
1.3 SHENJAT QË MUND TË SHFAQIN FËMIJËT QË JANË TË RREZIKUAR NGA RADIKALIZMI.....	6
1.4 TË RINJTË MË TË PREKSHËM NGA RADIKALIZMI	7
2. MODULI II - FËMIJË DHE TË RINJ TË SIGURT ONLINE	9
2.1 PËRKUFIZIME	9
2.2 NJOHURI MBI SITUATË AKTUALE TË FËMIJËVE ONLINE	9
2.3 BULLIZMI KIBERNETIK DHE EKSTREMIZMI I DHUNSHËM	10
2.4 KËSHILLA SI TË MBROHEMI NGA BULLIZMI	10
2.5 SI TË MBROHEMI ONLINE – NDARJA E INFORMACIONEVE	11
2.6 KËSHILLA SI TË RUAJMË INFORMACIONET PRIVATE ONLINE	11
2.7 KËSHILLA PËR PRINDËRIT SI TË NDIHMOJNË FËMIJËT	12

HYRJE

Çdonjëri prej nesh mund të jetë i ekspozuar dhe i prekshëm nga rrëfimet ekstremiste. Interneti po përdoret gjithnjë e më shumë nga grupet ekstremiste si mjet për të arritur ndjekës, duke pretenduar se mund të ofrojnë zgjidhje për problemet e përditshme në familje e shoqëri. Të rinjtë, të cilët janë përdorues më të shumtë të internetit, por edhe mund t'i besojnë me lehtë këtyre premtimeve, nevojitet që të kenë informimin e duhur rreth këtij rreziku online si dhe mbështetje në rast nevoje nga familja dhe strukturat e tjera në komunitetin e tyre.

Me mposhtjen e të ashtëquajturit Shteti Islamik i Irakut dhe Sirisë (ISIS), tashmë grupet ekstremiste që i kanë mbijetuar arrestimit dhe ndjekjes nga forcat e ligjit, mund të vazhdojnë të mbajnë komunikim dhe propagandojnë për ndjekësit e tyre nëpërmjet komunikimit online. ISIS ka dëshmuar tashmë se zotëron ekspertizë në komunikimin dhe teknologjinë elektronike falë përdorimit të metodave të rekrutimit online të luftëtarëve të huaj nga shumë vende të Evropës. Shqiptarët ishin një nga grupet e targetuara nga propaganda online e ISIS në vitet 2015-2017, e cila rezultoi efektive për radikalizimin dhe rekrutimin e mbi 500 luftëtarëve dhe familjeve të tyre nga trojet ku jetojnë në Ballkanin Perëndimor dhe Evropë.

Kjo eksperiencë në propagandimin nëpërmjet mediave sociale dhe videomesazheve mund të shfrytëzohet përsëri për të mbajtur gjallë lidhjet me personat e radikalizuar, por edhe për të rekrutuar anëtarë të rinj që mund të organizojnë sulme të armatosura në vende të ndryshme perëndimore. Si rrjedhojë, interneti vazhdon të mbetet një nga hapësirat ku është e nevojshme të shtohet fokusi i mekanizmave për të parandaluar dhe luftuar kundër ekstremizmit të dhunshëm, por edhe të forcohet edukimi i të rinjve për të njohur dhe kundërshtuar mesazhet e propagandës ekstremiste.

Ky udhërrëfyes synon që të informojë të rinjtë, por edhe publikun në përgjithësi mbi këtë temë të rëndësishme si dhe të ofrojë disa këshilla për të krijuar rezistencën e duhur ndaj ekstremizmit të dhunshëm online.

1. MODULI I - TË NJOHIM EKSTREMIZMIN E DHUNSHËM

1.1 PËRKUFIZIME

Më poshtë mund të gjeni disa koncepte bazë në diskutimin për ekstremizmin e dhunshëm:

Sjellje anti-sociale - Sjellje që kërcënon atmosferën e sigurt të shkollës apo komunitetit dhe përfshin, por nuk kufizohet vetëm në sjellje të tilla si bullizmi, ngacmimi, diskriminimi, racizmi, sjellja e paligjshme ose kriminale, dhuna fizike ose dëmtimi i shkollës ose objekteve të tjera.

Ekstremizmi - Kur një person ose grupim beson në pikëpamje, të cilat mendohen të paarsyeshme dhe të papranueshme nga shumica tjetër e njerëzve.

Ekstremizmi i dhunshëm - Kur një person ose grupim mendon që frika, terrori dhe dhuna janë mjete të justifikueshme për të arritur ndryshime ideologjike, politike ose shoqërore dhe më pas vepron mbi këto besime.

Radikalizimi - Procesi me të cilin një person adopton pikëpamje apo praktika ekstreme deri në pikën e legjitimitetit të përdorimit të dhunës.

Terrorizmi - Veprime apo një strategji e veçantë që përdoret për të arritur një objektiv ideologjik, politik ose shoqëror duke krijuar dhe shfrytëzuar qëllimisht frikën.

Kundëradikalizimi - Një paketë programesh sociale, politike, ligjore, arsimore dhe ekonomike të hartuara posaçërisht për t'i frenuar individët e pakënaqur (dhe, me gjasë, tashmë të radikalizuar) që t'i drejtohen terrorizmit.

Rezistencë/Qëndresë: Faktorët, idetë, institucionet, çështjet, prirjet ose vlerat që iu japin mundësi individëve dhe komuniteteve t'i bëjnë qëndresë dhunës ose ta parandalojnë atë.

Luftëtarë të huaj - Individë të cilët udhëtojnë drejt një shteti që nuk është shteti i tyre i qëndrimit apo nënshtetësisë, me qëllim kryerjen, planifikimin, përgatitjen apo pjesëmarrjen në akte terroriste ose ofrimin a përfitim të trajnimit terrorist, qoftë ai edhe në lidhje me një konflikt të armatosur.

1.2 EKSTREMIZMI I DHUNSHËM DHE RADIKALIZIMI

Ekstremizmi i dhunshëm lidhet me ato besime dhe veprime që mbështesin ose përdorin dhunën e motivuar ideologjiksht për të ngulitur pikëpamje ideologjike, fetare ose politike radikale¹.

Pikëpamjet e ekstremizmit të dhunshëm mund të shfaqen në një sërë çështjesh, duke përfshirë dhe marrëdhëniet politike, fetare dhe gjinore. Asnjë shoqëri, komunitet fetar ose pikëpamje botërore nuk është immune ndaj një ekstremizmi të tillë të dhunshëm:

¹ www.livingsafetogether.gov.au dhe www.dhs.gov/topic/countering-violent-extremism

Ekstremizmi i dhunshëm cilësohet situata kur ... “ti nuk lejon pikëpamje të ndryshme; kur mendon se pikëpamjet e tua janë të veçanta, kur nuk lejon mundësinë e të ndryshmes dhe kur do t'ua imponosh idetë e tua të tjerëve, nëse është e nevojshme, edhe përmes dhunës2.”

Megjithëse për termin “radikalizim” ka qëndrime të ndryshme, ai po përdoret për të përkufizuar procesin përmes të cilit, një individ ose grup e vlerëson dhunën si legjitime dhe si mjet të dëshirueshëm veprimi.

Për radikalizimin nuk ka një përcaktim ose drejtim të vetëm, sikurse nuk mund të përcaktohet as shpejtësia me të cilën ai mund të përhapet.³ Megjithatë, pranohet ndikimi i faktorëve socialë, ekonomikë, psikologjikë dhe institucionalë, të cilët të shtyjnë drejt ekstremizmit të dhunshëm.

Specialistët i grupojnë këta faktorë në dy kategori kryesore:

▶ **“Faktorët shtytës”** që i drejtojnë individët drejt ekstremizmit të dhunshëm, të tillë si: margjinalizimi, pabarazia, diskriminimi, persekutimi ose perceptimi i persekutimit; mundësia e kufizuar për arsim cilësor dhe të përshtatshëm; mohimi i të drejtave dhe lirive civile; dhe probleme të tjera mjedisore, historike dhe social-ekonomike.

▶ **“Faktorët tërheqës”** që ushqejnë tërheqjen ndaj ekstremizmit të dhunshëm, si për shembull: ekzistenca e grupeve të mirëorganizuara të ekstremizmit të dhunshëm me ligjërime imponuese dhe programe efektive, të cilat ofrojnë shërbime, të ardhura dhe/ose punësim në këmbim të anëtarësisë. Grupet mund të joshin anëtarë të rinj duke iu ofruar zgjidhje për problemet dhe duke iu premtuar aventurë dhe liri. Për më tepër, këto grupe duket se ofrojnë rehati shpirtërore, “ndjenjën e përkatësisë” dhe një rrjet social mbështetës.

Së fundi, ekzistojnë faktorë kontekstualë të cilët ofrojnë një terren të favorshëm për shfaqjen e grupeve të ekstremizmit të dhunshëm, të tillë si: shtetet e brishta, mungesa e shtetit të së drejtës, korrupsioni dhe kriminaliteti.

Disa shembuj të ekstremizmit të dhunshëm:

- Grupet neonaziste,
- Ku Kluks Klani,
- Ekoterrorizmi,

² <https://www.oise.utoronto.ca/cld/UserFiles/File/DAVIESeducationagainstextremism.pdf>

³ Davies, L. 2008. Edukimi kundër ekstremizmit: Drejt politizimit kritik të të rinjve. *International Review of Education*, 55 (2/3), f. 183-203. doi:10.1007/s11159-008-9126-8

- Shteti Islamik i Irakut dhe Sirisë (ISIS),
- Organizata Boko Haram.

Angazhimi i të rinjve ndaj ekstremizmit

Të rinjtë mund të nxiten të shfrytëzojnë energjinë dhe entuziazmin që i karakterizon për të krijuar dhe zhvilluar ide pozitive dhe zgjidhje të reja për sfidat e ekstremizmit të dhunshëm si dhe shqetësimet e tjera globale. Me njohuritë që kanë për krijimin e lidhjeve përmes mediave sociale, ndarja e përvojave ndërmjet tyre bëhet menjëherë realitet dhe ka potencial për t'u përhapur gjerësisht.

Shpesh, proceset demokratike të vendimmarrjes mund të gjykohen si tepër të ngadalta për të rinjtë, të cilët parapëlqejnë veprim të menjëhershëm. Për këtë arsye, duhet të identifikohen mënyra të shpejta për të krijuar ndryshim dhe ndikime pozitive në komunitet.

Përfshirja në proceset vendimmarrëse në nivelin lokal e qendror ose pjesëmarrja në veprimtari vullnetare ndihmojnë edhe në kultivimin e dëshirës së të rinjve dhe energjisë së tyre për ndryshim. Përmes pjesëmarrjes aktive në organizatat rinore dhe grupet informale, por edhe aktivitete sportive e kulturore, të rinjtë janë në gjendje të ushqejnë ndjenjën e shpresës, identitetit, shoqërisë dhe përkatësisë, të cilat i angazhojnë ata më shumë me komunitetin dhe i largojnë nga qasja ekstremiste.

Nxitja e shumëllojshmërisë së ideve dhe diskutimit mbi to ndërmjet nxënësve zvogëlon gjasat për zhvillimin e sjelljeve konfrontuese dhe ideologjive radikale. Studimet e fundit në këtë fushë nënvizojnë faktin se diskutimi i tematikave dyzuese, veçanërisht prirjet radikalizuese, duhet të inkurajohet në vend që të shtypet nga mësuesit. Duhet prezantuar nëpër ambjentet shkollore ideja se normat dhe vlerat ndryshojnë në kultura të ndryshme, në mënyrë që të promovohet mendimi kritik, shumëllojshmëria dhe përfshirja.

Përvoja e deritanishme ka treguar se fokusimi i ndërhyrjes vetëm në grupe të caktuara, nuk është një qasje efektive për parandalimin e fenomenit. Kjo qasje rrit ndjesinë e marginalizimit dhe mos përkatësisë, inkurajon fragmentimin dhe demonizon një grup të caktuar. Ndaj përfshirja në trajnime apo diskutime e të gjithë të rinjve është më efektive në arritjen e ndryshimeve pozitive.

1.3 SHENJAT QË MUND TË SHFAQIN FËMIJËT QË JANË TË RREZIKUAR NGA RADIKALIZMI

Nuk ka vetëm një rrugë drejt radikalizimit. Megjithatë, ka disa tipare të sjelljes që mund të tregojnë se dikush është ekspozuar ndaj radikalizimit. Radikalizimi i të rinjve mund të ndodhë gjatë një periudhe të gjatë kohore. Në disa raste ky fenomen nxitet nga një ngjarje ose një incident i caktuar dhe mund të ndodhë shumë më shpejt. Ndonjëherë ka shenja të qarta të radikalizimit, në raste të tjera ndryshimet janë më pak të dukshme.

Mosha e adoleshencës është koha e ndryshimit të madh dhe të rinjtë, që shpesh duan të jenë të pavarur, lehtësisht shprehin ndjenjën e zemërimit dhe shpeshherë të mosbesimit ndaj autoriteteve. Kjo e bën të vështirë për të dalluar sjelljen normale të adoleshencës dhe shenjave që tregojnë se një i ri mund jetë ekspozuar ndaj ndikimeve të radikalizimit.

Sjelljet e mëposhtme të renditura këtu synojnë të ndihmojnë në identifikimin e radikalizimit të mundshëm:

Pamja e jashtme

- Argumentimi i detajuar i qëndrimeve kundërshtuese
- Refuzimi për të dëgjuar pikëpamje të ndryshme
- Refuzimi për t'u shoqëruar me fëmijë të ndryshëm nga ata
- Sjellje abuzive ndaj fëmijëve që janë të ndryshëm
- Përqafimi i teorive të konspiracionit
- Ndjenja e persekutimit
- Ndryshimi i miqësive dhe pamjes së jashtme
- Largimi nga shokët e vjetër
- Mosbërja e aktiviteteve që më parë dëshironin
- Konvertimi në një fe të re
- Hezitimi për të treguar vendndodhjen e tyre
- Simpatia ndaj ideologjive dhe grupeve ekstremiste

Sjellje online

- Ndryshimi i identitetit në internet
- Pasja e më shumë se një identiteti online
- Shpenzimi shumë kohë në internet ose në telefon
- Përdorimi i përmbajtjes ekstremiste në internet
- Bashkimi ose përpjekja për t'u bashkuar me një organizatë ekstremiste

Pavarësisht këtyre shenjave të përgjithshme, janë familjarët dhe miqtë ata që i njohin më mirë njerëzit e tyre të afërt dhe mund të gjykojnë më shpejt nëse ata po veprojnë në mënyrë të dyshimtë.

1.4 TË RINJTË MË TË PREKSHËM NGA RADIKALIZMI

Çdo njeri mund të jetë i prekshëm nga ekstremizmi. Në vijim janë renditur disa faktorë kryesorë:

- Distançimi nga prejardhja kulturore ose fetare
- Pyetja për vendin që zënë në shoqëri
- Çështjet familjare
- Përjetimi i një ngjarje traumatike

- Përjetimi i racizmit ose diskriminimit
- Vështirësi në marrëdhëniet shoqërore
- Vështirësi në kuptimin e pasojave të veprimeve të tyre
- Vetëvlerësim i ulët

Secila nga këto çështje i bën të rinjtë më të prirur të besojnë se pretendimet e ekstremistëve janë përgjigje ndaj problemeve të tyre.

Faktorët e jashtëm luajnë gjithashtu rolin e tyre, siç janë: tensionet e komunitetit, ngjarjet që prekin vendin ose rajonin ku ata ose prindërit e tyre janë, ose kanë miq ose familje që u janë bashkuar grupeve ekstremiste. Ekspozimi ndaj pikëpamjeve të njëanshme kontribuon në procesin e radikalizimit. Ata të rinj të përfshirë në grupe kriminale, ose që kanë pasur vështirësi për t'u riintegruar, mund të jenë gjithashtu në rrezik.

Prindërit në këtë fazë duhet të bëjnë shumë kujdes nëse identifikojnë një apo disa nga shenja të sipërpërmendura. Ata duhet të tregohen të qetë dhe të mundohen të komunikojnë me fëmijën. Është e nevojshme që të komunikohet pozitivisht dhe jo t'u kërkohet atyre llogari. Në shumicën e rasteve është e nevojshme që të informohet edhe shkolla për shqetësimin që kanë prindërit, pasi mësuesit janë partnerët kryesorë në identifikimin dhe menaxhimin e problematikave të ndryshme.

Prandaj, tregohuni bashkëpunues dhe kontaktoni here pas here lidhur me ecurinë e fëmijës në shkollë. Në këtë moment ju si prindër duhet të krijoni një klimë pozitive dhe të qetë në shtëpi. Mundohuni ti jepni rendësi fëmijës dhe ti tregoni se për ju vlen më shumë se gjithçka, dhe që jeni pikërisht ju ata që do i mbrojnë dhe do i orientoni drejt zgjidhjeve të problemeve. Filloni duke ilustruar një shembull pozitiv nga vetja duke mos shpenzuar shumë kohë në telefon apo jashtë shtëpisë, por duke ia dedikuar këtë kohë fëmijës. Gjithashtu, informoni fëmijën tuaj drejt situatës që përjetohet në vende luftimi, keqtrajtimit dhe abuzimeve të ndryshme që ndodhin. Në varësi të moshës mund të ndani me ta edhe video apo shkrime të ndryshme. Përpiquni t'u tregoni se përdorimi i internetit jo të kontrolluar apo shoqërimi me persona të dyshuar si rekrutues do të ndryshojë për keq rrjedhën e jetës së tyre. Po ashtu, tregojuni raste të mundshme të shokëve të tyre në komunitet apo Botë, të cilët janë bërë pjese e grupeve të ndryshme terroriste.

2. MODULI II - FËMIJË DHE TË RINJ TË SIGURT ONLINE

2.1 PËRKUFIZIME

Më poshtë mund të gjeni disa koncepte bazë:

Cyber- Bullying - Bullizmi kibernetik ndodh kur një fëmijë apo adoleshent kërcënohet, keqtrajtohet, poshtërohet, tallet, ofendohet, apo vihet në shënjestër në mënyrë të qëllimshme nga një fëmijë ose adoleshent tjetër duke shfrytëzuar përdorimin e internetit, teknologjinë digjitale ose telefonat celularë.

Mik online - Miqtë e internetit mund të përkufizohen si një miqësi midis dy njerëzve që janë takuar online dhe që vetëm e njohin njëri tjetrin nëpërmjet internetit.

Sexting - Dërgimi i një imazhi provokues, foto intime, apo foto personale duke përdorur telefonin.

Grooming - Proçesi i përdorur nga “grabitqarët” e internetit për të fituar besimin e viktimave dhe për të ndërtuar marrëdhënie të rreme.

Social Netëorking - Një faqe interneti ku dikush lidhet me ata që ndajnë interesa personale ose profesionale.

Virus - Softëare që dëmton kompjuterin: vjedhje të dhënash, fshirje skedarësh. Viruset zakonisht shkarkohen dhe instalohen aksidentalisht nga skedarë në internet.

2.2 NJOHURI MBI SITUATË AKTUALE TË FËMIJËVE ONLINE

Interneti dhe teknologjia është bërë pjesë e pandashme e jetës së përditshme, veçanërisht për fëmijët dhe të rinjtë. Për këtë arsye platformat online janë përqafuar nga grupe ekstremiste të dhunshme, të cilët gjithmonë e më shpesh po e përdorin teknologjinë për të promovuar dhunën dhe gjuhën e urrejtjes mbi baza etnike, fetare, gjinore e kulturore, për të rekrutuar të rinjtë e për të krijuar komunitete online me shtrirje globale, në të cilat inkurajohen pikëpamjet e sjelljet e dhunshme, duke kontribuar kështu në proceset e radikalizmit.

Këto grupe shpesh mund të ofrojnë zgjidhje të rreme për problemet e përditshme në familje e shoqëri apo marginalizimin (trajtimin jo si të rëndësishëm) e të rinjve. Një studim i mbështetur nga Akademia e Studimeve Politike në vitin 2015⁴, zbuloi një strategji të sofistikuar komunikimi online publik të ISIS në gjuhën shqipe, me synim rekrutimin e tyre si luftëtarë në zonat e konfliktit. Vetëm 30 përqind e mesazheve përbëhej nga diskutimeve ideologjike dhe fetare, ndërkohë që pjesën të madhe të diskutimeve e kishin premtimet për një jetë më të mirë në territoret ku luftohej.

Referuar studimit të UNICEF Albania “Eksperiencat e fëmijëve në përdorimin e Internetit në Shqipëri”, më shumë se 20% e fëmijëve të anketuar pranojnë të gjitha kërkesat për shoqëri në rrjete sociale, 25% e fëmijëve kanë bashkëvepruar online me dikë që nuk e njohin në jetën reale,

⁴ Strategjia e komunikimit online publik të ISIS në Shqipëri - 2015
http://www.asp.al/pdf/Strategjia_e_komunikimit_te_IS_-_Koncept_paper_13_Nentor.pdf

16% e fëmijëve kanë takuar personalisht dikë që e kanë njohur në internet dhe prindërit kanë njohuri vetëm për 9% të eksperiencave të fëmijëve në internet.

Megjithatë mbrojtja e fëmijëve dhe të rinjve duhet të jetë proporcionale me rreziqet që ata hasin dhe nuk duhet të pengojë përdorimin e teknologjive të informacionit për rritjen, edukimin dhe zhvillimin e tyre. Zgjedhja më e mirë në vend të masave ekstreme, mbetet edukimi që fëmijët të kuptojnë se jo çdo gjë që thuhet në një faqe interneti është e vërtetë si dhe komunikimi i vazhdueshëm më ta.

2.3 BULLIZMI KIBERNETIK DHE EKSTREMIZMI I DHUNSHËM

Bullizmi kibernetik është përdorimi i teknologjisë (internet, celular) për të dhunuar dikë online. Ky proces mund të nxisë përjashtimin social dhe marginalizimin, dhe si i tillë, mund të krijojë një terren të mundshëm për ekstremizmin e dhunshëm. Për këtë arsye të dy fenomenet janë të lidhura ngushtësisht dhe duhet të trajtohen me seriozitet nga institucionet dhe komuniteti.

Bullizmi kibernetik ndodh kur një fëmijë apo adoleshent kërcënohet, keqtrajtohet, poshtërohet, tallet, ofendohet, apo vihet në shënjestër në mënyrë të qëllimshme duke shfrytëzuar përdorimin e internetit, teknologjinë digjitale ose telefonat celularë.

Bullizmi kibernetik mund të shfaqet në disa forma, si:

- E-maile, mesazhe kërcënuese, fyese, tallëse e paragjyuese
- Etiketime fyese nëpërmjet postimeve në rrjetet sociale
- Postimi i fotografive, videove të personave të tjere pa miratimin e tyre, me qëllim talljeje dhe fyerje
- Krijimi i profileve false në rrjetet sociale në emër të një individi tjetër me qëllim talljeje apo fyerjeje
- Postime tallëse ose fyese në rrjetet sociale

2.4 KËSHILLA SI TË MBROHEMI NGA BULLIZMI

Këshilla për bashkëmoshatarët:

- Injoro – mesazhet kërcënuese apo tallëse!
- Blloko personin që t'i dërgon!
- Tregojini një të rrituri tek i cili ke besim se ai do të ndihmojë të informosh.
- Krijë një llogari të re – informacionin për llogarinë e re të krijuar shpërndaje vetëm në njerëz të cilët ke besim.

Raporto tek faqja nga e cila ke marrë kërcënimin – Shumica e faqeve kanë mënyra për të raportuar bullizmin kibernetik dhe fshijnë/heqin postimet që janë bërë kundër jush.

Nëse dikush është lënduar ose kërcënuar online, kurrë nuk është vonë t'i tregosh një personi të rritur të cilit i beson. Mos i kërcëno, as mos i tall të tjerët online. Të kërcënosh, tallësh të tjerët në internet nuk do të bëjë më të rëndësishëm se ata.

2.5 SI TË MBROHEMI ONLINE – NDARJA E INFORMACIONEVE

Informacionet personale mund të jenë emri i plotë, fotot, vendndodhja, adresa e shtëpisë ose shkollës, numri i telefonit, fjalëkalimet e llogarive të mediave sociale / emailit.

Më poshtë renditen disa hapa për të mbrojtur veten në internet:

- Kontrolllo komentet dhe imazhet.
- Fol me miqtë më të ngushtë për t'u konsultuar mbi përmbajtjet që zgjedh të postosh.
- Herë pas here kontrolllo Account Setting / Privacy Setting të llogarive të tua në mediat sociale.
- Duhet të njohësh miqtë dhe ndjekësit që ke në rrjetet sociale.
- Bëji të gjitha llogaritë private që të mbrosh privatësinë.
- Hiqe emrin e plotë nga llogaria dhe çdo lloj informacioni tjetër që ka të bëjë me vendbanimin apo shkollën ku studion.

2.6 KËSHILLA SI TË RUAJMË INFORMACIONET PRIVATE ONLINE

Disa këshilla për ruajtjen e informacioneve private online:

- Mos jep informacion rreth adresës së shtëpisë, shkollës apo numrin e telefonit personave të panjohur dhe/ose atyre që ke njohur në internet;
- Mos shkarko foto ose video të dërguara nga adresa apo persona të panjohur ose që ke njohur në internet;
- Mos i dërgo fotografitë e tua personale tek të panjohur. Ti asnjëherë nuk e di se si mund të përdoren ato nga të tjerët;
- Tregoj me kujdes prindërve, familjarëve më të rritur, mësuesit tuaj, psikologut të shkollës nëse ndiheni të rrezikuar ose të frikësuar;
- Kujtoni se personi që mund të njihni në internet mund t'iu thotë se është moshatari juaj, por në të vërtetë mund të jetë një i rritur, i cili kërkon t'ju lëndoje;
- Mos lër takim dhe mos u tako me një person me të cilin je njohur vetëm nëpërmjet internetit;

- Asnjëherë nuk e dini se cili qëndron në anën tjetër të kompjuterit! Tregohuni të kujdesshëm!
- Bisedo me mësuesin dhe psikologun e shkollës;
- Telefono: ALO 116 111 – Linjën Kombëtare të Këshillimit për Fëmijë për të raportuar çdo shqetësim;
- Në rast situatash të rrezikshme kontakto me Policinë në numrin 112 dhe 129.

Nëse dikush që ke takuar online të kërkon të bësh gjëra për të cilat mund të mos ndihesh rehat, ose po kërkon që t'ju takojë personalisht, disa zgjidhje janë:

- Fshiji nga lista e miqve.
- Mos prano t'ju takosh personalisht.
- Fol me një të rritur tek i cili ke besim për situatën e krijuar.

Mos i beso askujt që njeh online nëse ai/ajo:

- Të dërgon dhurata: telefon celular apo dhe kamera, paguan taksinë që t'ju të shkosh ta takosh;
- Të bën të ndjehesh në faj dhe me turp.
- Të tregon foto ose kërkon që edhe ti t'ju dërgosh foto personale.
- Të mëson të mos iu tregosh prindërve apo dhe shokëve/shoqeve për gjërat që flisni, shikoni, diskutoni apo bëni me njëri-tjetrin

Raporto tek Prindërit, Linja 116-111, Policia, Punonjësit e mbrojtjes së fëmijëve në Bashki, Mësuesi/Psikologu nëse të dhënat tuaja personale keqpërdoren nga të tjerët në Internet.

2.7 KËSHILLA PËR PRINDËRIT SI TË NDIHMOJNË FËMIJËT

Të rriturit mund të të ndihmojnë duke i dëgjuar fëmijët, si dhe duke:

- ruajtur screenshot ose foto të mesazheve, orën kur ka ndodhur.
- lidhur me shkollën; mësuesja ose psikologu/psikologjia e shkollës duhet ta dinë nëse fëmijët janë tallur/kërcënuar nga një bashkëmoshatar, kjo me qëllimin e vetëm për t'ju mbrojtur.

Prindërit mund të përmirësojnë eksperiencat e fëmijëve në internet duke aplikuar disa metoda për kontrollin prindëror si:

- Limitimi i kohës që fëmijët përdorin internetin – prindërit mund të limitojnë kohën në aksesimin e përmbajtjeve të caktuara në internet ose të ndalojnë aksesimin e tipeve të caktuara të përmbajtjes në orë të caktuara gjatë ditës.
- Filtrimi i përmbajtjes – parandaloni aksesimin e përmbajtjeve për më të rritur

- Monitorimi – vëzhgoni e kontrolloni aktivitetet që realizon fëmija gjatë përdorimit të pajisjeve

Rregulla për të mbrojtur fëmijët nga përdorimi i rrjeteve sociale:

- Mos i nxisni fëmijët të përdorin media sociale pa arritur moshën e pjekurisë.
- Sigurohuni që kompjuteri të mbahet në një vend ku mund të shihni aktivitetet e tyre.
- Vendosni afate kohore për kohën që mund të kalojë fëmija juaj në mediat sociale.
- Sigurohuni që t'i kushtoni vëmendje përmbajtjeve që ata pëlqejnë, ndajnë dhe postojnë.
- Bllokoni opsionet e vendndodhjes (location) për aplikacionet ose mediat sociale që përdorin fëmijët.

Rregullat për sigurinë e fëmijëve gjatë lojërave në internet:

- Aplikoni kontrollet prindërore në mënyrë që të kufizoni llojin e lojërave ku mund të hyjnë fëmijët në internet
- Sigurohuni që profili i tyre i lojrave të jetë vendosur privat
- Nëse keni më shumë se një fëmijë, sigurohuni që secili të ketë hapur profilin e tij sipas kufizimeve të moshës.
- Sigurohuni që të rishikoni udhëzimet e moshës për lojërat që ata po luajnë në internet
- Kufizoni njerëzit me të cilët mund të flasin në internet kur luajnë ose fikeni opsionin për të komunikuar me të tjerët gjatë lojës

Rregulla për sigurinë e pajisjeve elektronike të fëmijëve:

- Sigurohuni të kontrolloni aplikacionet e reja të instaluar në telefon. Nëse nuk mund ta bëni këtë, përpquni të zbatoni një rregull që fëmija juaj duhet të marrë leje nga ju së pari. Në shumicën e rasteve, kërkohet një fjalëkalim përpara se të lejohet shkarkimi i programeve reja.
- Flisni me fëmijën tuaj për llojin e përmbajtjeve që duhet të kenë më shumë kujdes, si mesazhet ose telefonata nga numra të panjohur, kërkesa miqësie nga persona të panjohur.
- Sigurohuni që fëmija juaj nuk ua jep numrin e telefonit celular në internet ashtu edhe offline njerëzve të panjohur pa marrë më parë lejen tuaj.
- Sigurohuni që fëmijët të mos postojnë komente të pakëndshme në Internet. Nëse nuk do t'i thoni diçka dikujt personalisht, atëherë mos e bëni atë në internet.
- Jini të vetëdijshëm për çdo rregull që shkolla ka rreth përdorimit të telefonit celular dhe sigurohuni që fëmija juaj t'i kuptojë ato qartë.
- Mos lejoni që fëmija juaj të marrë telefonin e tij në shtrat me vete. Kjo gjë jo vetëm që do t'i ndalojë ata të flenë, por ka të ngjarë të çojë në vëmendje të padëshiruar.

Interneti është burim i pasur informacioni për fëmijët e të rinjtë. Si prind, është e rëndësishme që të përdorni komunikimin sa më të drejtëpërdrejtë me fëmijët.

Dialogimi i hapur me fëmijën, prezenca juaj kur ata kanë nevojë dhe matura, janë elementë të rëndësishëm që fëmijët të tregohen të hapur për problemet që hasin.

Jini dëgjues të mirë. Mos harroni se fëmijët duhet të mësojnë dhe është detyra juaj të lehtësoni mësimin e tyre në mënyrë të sigurt dhe produktive. Mos u shqetësoni për vështirësinë e përdorimit të mjeteve të teknologjisë, fatmirësisht autoritetet përgjegjëse dhe operatorët e shërbimit të internetit luajnë të gjithë së bashku një rol të rëndësishëm për ta bërë më të lehtë për fëmijën tuaj qasjen në internet në një mënyrë të kontrolluar dhe të sigurt.

Qershor 2020